

L I G J
Nr. 7498, datë 5.7.1991

PËR RUAJTJEN E RENDIT E TE QETESISE

Ne mbështetje te nenit 16 te ligjit nr.7491 datë 28.4.1991 "Për dispozitat kryesore Kushtetuese", me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË

V E N D O S I

Neni 1

Ne territorin e Republikës se Shqipërisë te gjithë shtetasit shqiptare, te huaj dhe persona pa shtetesi, jane te detyruar te respektojnë rregullat e bashkejetesës shoqerore.

Neni 2

Ndalohet kryerja e veprimeve qe shqetesojne te tjeret, si grindjet, provokimet, te bertiturat si dhe hapja me ze te larte e radiomagnetofoneve e mjeteve te tjera te kesaj natyre ne vendet publike.

Neni 3

Tregtimi i pijeve alkoolike behet ne lokale shteterore dhe ne ato private te hapura sipas dispozitave ne fuqi.

Ndalohet tregtimi i pijeve alkoolike ne pikat ambulante, autobuze, trenat e udhetareve, trotuare, rruge, lulishte e vend te tjera jashte tyre te caktuara Për kete qellim.

U ndalohet shitja e pijeve alkoolike personave qe jane ne gjendje te dehur, te semure psikike si dhe te miturve nen moshen 16 vjeç.

Personat e duhur qe cenojne rendin e Qetësisë ne mjedise e lokale publike, shoqerohen Për ne organin e policise dhe mbahen aty deri sa tu dale pija.

Neni 4

Shtetasit jane te detyruar te zbatojnë rregullat dhe rradhen e hipjes, qendrimit dhe te zbritjes ne mjetet e transportit qytetar. Ata jane te detyruar te pajisen me biletën perkatese te udhetimit dhe te respektojnë rregullat e vendosura nga Ministria e Transporteve.

Ndalohet goditja me gure ose me sende te tjera e mjeteve te transportit, perdorimi pa shkaqe te justifikuara i frenit te sigurimit ne trenat e udhetareve si dhe demtimit i ndenjeseve e cdo pajisje tjeter te ketyre mjeteve.

Neni 5

Ne mjediset ku zhvillohen veprimtari kulturore e sportive shtetasi jane te detyruar te pajisen me biletën perkatese te aktivitetit, si dhe te zbatojnë rregullat e hyrjes e te qendrimit ne to.

Ndalohet ne keto mjedise tregtimi i pijeve alkoolike dhe perdorimi i tyre, ndezja e zjarreve, perdorimi i fjaleve fyese, hedhja e sendeve te ndryshme ne mjedisit ku zhvillohet aktiviteti si dhe pirja e duhanit ne sallat dhe mjediset e mbyllura.

Neni 6

Ndalohet zënia dhe perdorimi arbitrazhit i apartamenteve te banimit apo i mjediseve te tjera shteterore ose private pa lidhur me pare kontratën perkatese.

Ne keto mjedise, me kerkese me shkrim te personit juridik te interesuar, organi i policise urdheron kundravajtesit te liroje menjerehe banesen ose mjedisn e zene padrejtesisht.

Mxjerrja e materialeve nga banesa e zene arbitrarisht behet nga personi juridik i interesuar. Shpenzimet perballohet nga kundervajtesi. Policia siguron paprakashmerine e personit juridik.

Neni 7

Ndalohet vendosja e afisheve e komunikatave dhe e parullave ne muret e godinave, institucioneve shtetore e ne monumentet e historise e te kultures. Ne muret rrethuese apo fasadat e selive te turpit diplomatik e ato te partive organizatave politike e shoqerore, keto vendosen vetem me aprovimin e pronareve te tyre.

Neni 8

Ndalohet perodrimi i kujave dhe i kafsheve te tjere Për hipizem ne qytetet dhe ne qendrat e banuara ku ka rrezik Për jeten dhe shendetin e shtetasve.

Neni 9

Organet lokale te pushtetit, ne bashkepunim me organet e policise, caktojne rruget, bulevardet e sheshet qe do te perdoren Për shetitore si dhe vendet Për luajtjen e famijeve.

Ndalohet levizja e automjeteve, bicikletave dhe e mjeteve te tjera ne oret dhe ne vendet e caktuara si shetitore dhe ne ato ku luajne famijet.

Neni 10

Shtetasit jane te detyruar te zbatojne rregullat e vendosura nga administratat perkatese ne frekuentimin e parqeve, lulishteve, pishinave e veprave te artit. Keto rregulla duhet te behen te njohura ne hyrje te mjedisit.

Ndalohet keputja, shkulja dhe cdo demtim tjetër i luleve, pemeve dekorative dhe i pajisjeve te tjera te mjedist.

Neni 11

Ndalohet tregtimi i frutave, perimeve, kafsheve, shpendeve, si dhe i sendeve te tjera jashte vendeve te caktuara nga organet lokale te pushtetit.

Neni 12

Shtetasit qe kane ne perdorim autovetura dhe motorcikleta shtetore ose private detyrohen ti parkojne dhe ruajne ne vendet e caktuara Për kete qellim, ne ndermarrje ose prane banesave te tyre.

Ndalohet lenia e ketyre mjeteve te pasuiguruara si dhe ne rruge e vende te tjera qe nuk sherbejne Për kete qellim.

Neni 13

Pergjegjesi i lokalit shtetor ose privat, eshte i detyruar te marre masa Për sigurimin e objektit ku mban e ruan vlera materiale e monetare.

Ne rastet kur lokali lihet i pasiguar apo paraqet rrezik zjarri, punonjesi i policise ka te drejte te therrase ne cdo kohe pronarin dhe ta detyroje ate te marre masat e duhura.

Neni 14

Pergjegjesi i lokave shtetore ose private jane te detyruar te mos ndotin mjedisin perreth me hedhurina, mbeturina etj, por ti sistemoje ato ne vendet e lejuara.

Neni 15

Personat juridike a fizike qe bejne ndertime ne qytet jane te detyruar ta marrin masa sigurimi si rrethim, ndricim, tabela e shenja paralajmeruese Për parandalimin e aksidenteve si dhe te kene marre lejen perkatese te ndertimit nga organi kompetent.

Kur kero masa nuk jane te plota, punonjesi i policise ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet deri ne vendosjen e tyre.

Neni 16

Banoret e pallateve detyrohen te marrin masa Për sigurimin e jetes dhe te shendetit te shtetasve qe kalojne prane apartamenteve te tyre nga gnjarjet aksidentale.

Ndalohet vendosja dhe lenia pa siguruar e vazove te luleve dhe objekteve te tjera ne parvazet e dritareve dhe ne ballkone.

Neni 17

Shtetasit qe kane qen ne shtepi ndalohen ti lenë ata zgjidhur apo ti nxjerrin ne rruge pa i shoqeruar.

Organet lokale te pushtetit organizojne vrasjen e qenve qe qarkullojne ne rruge te pashoqeruar e qe paraqesin rrezikshmeri ne jeten e shendetin e qytetareve.

Neni 18

Ndalohet levizja, qendrimi e kullotja e bagetive ne mjediset e ndryshme te qyteteve, mbajtja e shpendeve dhe kafsheve shtepiajeve ne mjediset e banimit kolektiv ne qytet si dhe prane tyre.

Punonjesi i policise urdheron largimin e menjehershëm te, tyre. Ne rast te kundert merr masen e gjobes ne vend dhe ben sekuestrimin e tyre. Shpendet dhe kafshet e sekuestruar dergohen ne ndermarrjet e grumbullimit dhe vlera shkon ne llogari te buxhetit te shtetit.

Neni 19

Ne mjediset e plazhit, lokalet dhe shtepite e pushimit, shtetasit jane te detyruar te zbatojne rregullat e brendshme te vendosura nga administrata e tyre.

Ndalohet luajtja me top ne rere, futja dhe qendrimi me kostum banjoje ne lokalet e tregtise dhe nmjediset e tjera publike, duke perjashtuar ato ambulate.

Neni 20

Për shkeljen e dispozitave te mesiperme, perve masave e kufizimeve te parashikuara ne nenet perkatese, punonjesit e policise kane te drejte ti japin kundervajtesit gjobe ne vend nga 10-300 leke.

Gjoba qe parashikohet ne nenin 6 te ketij ligji te jepet nga 500-1000 leke.

Neni 21

Kundervajtesit jane te detyruar te paguajne gjoben brenda 5 diteve nga koha e venies se saj. Për cdo dite vonese paguhet nje shtese prej 2 Për qind te mases se gjobes se vene. me kalimin e afatit mbi nje muaj, vjelja e gjobes behet sipas dispozitave perkatese.

Neni 22

Ngarkohet ministri i Renit Publik te percaktoje punonjesit e policise qe ngarkohen me mbikeqyrjen dhe zbatimin e ketij ligji dhe kompetencat e tyre.

Neni 23

Dispoxitat ligjore qe bien ne kundershtim me kete ligj shfuqizohen.

Neni 24

Ky ligj hyn ne fuqi menjehere.

PRESIDENTI I REPUBLIKES
RAMIZ ALIA